



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komuna Klinë – Trupa Punuese

02 Nr. 052-10340/24
Klinë, me 28.03.2024

Duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040, statutin e Komunës së Klinës, nr.01-110-1232 dt.31.03.2020, Udhëzimin Administrativ (MAPL) për Administratë të Hapur në Komunë, Nr.04/2023, Komuna e Klinës, përkatësisht Trupa punuese për hartimin e draftit për strategjinë komunale për mbrojtje nga dhuna në familje (2024-2027) dhe planin e veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje (2024-2026):

NJOFTON PUBLIKUN - PALËT E INTERESIT

Se ka vën në konsultim publik draftin për strategjinë komunale për mbrojtje nga dhuna në familje (2024-2027) dhe planin e veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje (2024-2026).

Qëllim kryesor i vënies në konsultim publik i draftit për strategjinë komunale për mbrojtje nga dhuna në familje (2024-2027) dhe planin e veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje (2024-2026), është të sigurojë opinionet, komentet dhe rekomandimet nga grupet e caktuara të interesit përkitazi me përmbajtjen e kësaj Strategjie dhe planit të veprimit. Konsultimi publik me akterët përkatës do të ndikojë drejtpërdrejtë në cilësinë e përmbajtjes së strategjisë dhe planit të veprimit.

Strategjia komunale për mbrojtje nga dhuna në familje (2024-2027) dhe planin e veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje (2024-2026) në konsultim publik do të jetë nga data **28.03.2024** e deri me datën **11.04.2024**, ndërsa debati publik me palët e interesit do të mbahet me datën **08.04.2024**, ditë e mërkure, në sallën e Kuvendit Komunal me fillim nga ora **13:30**.

Të gjitha komentet e pranuar deri në këtë afat do të përmbledhen nga ana e trupës punuese. Kontributet me shkrim duhet të dorëzohen në formë fizike tek kryesuesi i trupës punuese apo në formë elektronike në e-mail adresën: binak.sylaj@rks-gov.net me titull Drafti i strategjisë komunale për mbrojtje nga dhuna në familje (2024-2027) dhe planin e veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje.

Për më shumë detaje rreth draftit për strategjinë komunale për mbrojtje nga dhuna në familje (2024-2027) dhe planin e veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje, mund ti vizitoni vegzat e mëposhtme:
Uebfaqen zyrtare të Komunës së Klinës në rubrikën Konsultimet publike : <https://kk.rks-gov.net/kline/category/konsultimet-publike/>; dhe
Platforma e konsultimeve publike : <https://konsultimet.rks-gov.net/>

Kryesuesi i trupës punuese

Binak Sylaj

